

# Arsimi në shërbim të zhvillimit



RAPORTI 2016

Prishtina  
po bëhet



# Çerdhe në çdo lagje

Në fillim të mandatit, u zotuam që gjatë qeverisjes tonë do të sigurojmë çerdhe me çmim të përballueshëm në lagjet ku mungojnë çerdhet publike. Gjatë periudhës trivjeçare arritëm të bëjmë vlerësimin e nevojave për çerdhe dhe të hapim katër çerdhe me bazë në komunitet dhe tri të tjera janë në përfundim e sipër.

Vlerësimi i nevojave - Është bërë vlerësimi i nevojave për çerdhe në të gjitha lagjet dhe fshatrat e Komunës së Prishtinës dhe kemi përgatitur planin aksional për hapjen e çerdheve të reja me çmim të përballueshëm, në çdo pjesë të Prishtinës.

Hapja e çerdhes "Botanika", në lagjen "MATI II" – 80 fëmijë, më 17 gusht 2015;

Hapja e çerdhes "Ngjyrat", në lagjen "Hajvalia" – 40 fëmijë, më 26 tetor 2015;


Hapja e çerdhes "Shtëpia Magjike", në fshatin Besi – 40 fëmijë, më 18 dhjetor 2015;

Hapja e çerdhes "Shkronjat" në lagjen "Arbëria III" – 101 fëmijë, më 19 maj 2016;

Është në proces të hapjes çerdhja "Zogjtë" në lagjen Sofalia – 70 fëmijë, janar 2017;

Është në përfundim ndërtimi i çerdhes në lagjen "Kodra e Trimave" – 240 fëmijë, hapja në mars 2017;

Ka filluar renovimi i objektit për hapjen e çerdhes në lagjen "Tophane" – 60 fëmijë, mars 2017.



# Çerdhe me kosto të përballueshme



Çmimi në çerdhet me bazë në komunitet është 100 euro në muaj.  
Por, në bazë të të ardhurave mujore që marrin të dy prindërit,  
Komuna e Prishtinës subvencionon një pjesë të pagesës:

**Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 euro,**  
Komuna i subvencionon me vlerë 50 euro në muaj për fëmijë.

**Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro,**  
Komuna i subvencionon me vlerë 30 euro në muaj për fëmijë.

**Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro,**  
Komuna i subvencionon me vlerë 20 euro në muaj për fëmijë.

**Prindërit me të ardhura mujore mbi 1000 euro**  
nuk subvencionohen nga Komuna dhe paguajnë pagesën e plotë.



## Në Prishtinë, çdo fëmijë mundet!

Kifle dhe qumësht falas për të gjithë fëmijët në klasat 1-5 dhe për nxënësit e klasave të 6-9-ta në shkollat e përfshira në mësimin tërëditor. Në vitin e parë të mandatit arritëm të sigurojmë kifle për të gjithë fëmijët në klasat 1-5. Ndërsa në vitin 2015, me paratë që kursyem në shpenzime për dreka/darka dhe në karburante, arritëm që përveç kifleve, të sigurojmë edhe qumësht. Përmes këtij projekti kemi arritur të sigurojmë që asnje fëmijë të mos jetë i uritur gjatë orëve mësimore.

Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla dhe çerdhe.

Ekipi profesional për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ka operuar sipas planifikimeve dhe dinamikës së paraparë për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Gjatë vitit 2016, nga ekipi vlerësues janë vlerësuar njëzet e katër (24) nxënës, të cilët kryesisht vuajnë nga dëmtimet intelektuale dhe fizike, ku komisioni ka rekomanduar tetë (8) nga nxënësit të vijojnë mësimin në Qendrën burimore "Përparimi" dhe të tjerët në shkollat e rregullta;

Numri i fëmijëve të integruar është 441 fëmijë



Promovimin e leximit tek fëmijët e shkollave filllore – Në kuadër projektit “PRISHTINA LEXON” përmes të cilit synojmë të nxism dëshirën dhe të krijojmë shprehi të leximit tek fëmijët, për tri vite radhazi kemi organizuar kampanjën e leximit “Prishtina lexon” dhe garën për “Përrallën më të bukur për Prishtinën”, “Novelen më të mirë grafike” si dhe “Lexuesi më i mirë veror”.

Duke e ditur se qëllimi i këtij projekti nuk mund të realizohet vetëm përmes kampanjave dhe garave, kemi filluar investimet edhe nëpër shkolla, duke shndërruar këndet e pasfrytëzueshme nëpër shkolla në hapësira atraktive në KËNDE TË LEXIMIT.

Këndet e leximit të realizuara në 2015:

- SHFMU “Dardania”-Prishtinë
- SHFMU “Naim Frashëri” - Prishtinë
- SHFMU “Faik Konica” - Prishtinë
- SHMFU “Nexhmi Mustafa” – Besi
- SHFMU “Ismail Qemali” – Prishtinë
- SHFMU “Model” – Prishtinë
- SHFMU “Afrim Gashi” – Hajvali
- SHFMU “Anton Zako Çajupi” – Bardhosh
- SHFMU “Elena Gjika” – Prishtinë
- SHFMU “Hilmi Rakovica” – Prishtinë
- SHFMU “Hasan Prishtina” – Prishtinë
- SHFMU “Xhavit Ahmeti” – Prishtinë



Këndet e leximit të realizuara në 2016:

- SHFMU “Xhemail Mustafa”- Prishtinë
- SHFMU “Asim Vokshi”- Prishtinë
- SHFMU “Iliria”- Prishtinë
- SHMFU “Emin Duraku” – Prishtinë
- SHFMU “Dituria” – Shkabaj, Prishtinë
- SHFMU “Zenel Hajdini ” – Prishtinë
- SHFMU “Gjergj Fishta” – Prishtinë
- SHFMU “Nazim Gafurri” – Prishtinë
- SHFMU “7 Marsi” – Prishtinë
- SHFMU “Mitrush Kuteli” – Prishtinë
- SHFMU “Ali Kelmendi” – Barilev, Prishtinë
- SHFMU “Pjeter Bogdani” – Prishtinë
- SHFMU “Rilindja” – Keqekollë, Prishtinë
- SHFMU “Nëna Terezë” – Vranidoll, Prishtinë



**26** kënde të leximit

Investim në pajisje shkollore për të lehtësuar çantat e fëmijëve – Tashmë në të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës janë vendosur dollapët për secilin fëmijë (klasat 1-5).

### **Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme shkollore**

- **102 kabinete të reja** për fizikë, kimi, biologji dhe farmaci;
- **Pajisja e 29 institucioneve** edukativo-arsimore me pajisje teknologjike (90 kompjuterë, 65 laptopë, dhe 30 projektorë);
- **Pajisja e 7 shkollave me biblioteka shkollore;**

Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive në këto shkolla:

SHFMU "Dardania" - është rregulluar tereni sportiv

SHFMU "Naim Frashëri" – oborri

SHFMU "Faik Konica" – në proces


SHFMU "Gjergj Fishta" – është rregulluar tereni sportiv

SHMFU "Nexhmi Mustafa" – është rregulluar terreni sportiv

SHFMU "Ismail Qemali" – është rregulluar terreni sportiv dhe oborri

Ka filluar implementimi i projektit për digitalizimin e ditarëve në 5 shkolla fillore dhe të mesme të larta.

**102 kabinete të reja**  
për fizikë, kimi,  
biologji dhe farmaci





# Mbështetje dhe mbikëqyrje të vazhdueshme institucioneve edukativo-arsimore në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim

## Përzgjedhja e drejtoreve të shkollave me pjesëmarrje në komunitet

Sektori i Burimeve Njerëzorë në Komunën e Prishtinës, aplikon formularët standard për përzgjedhjen e stafit drejtues në institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar, të cilët janë edhe në përputhje të plotë me rregullat dhe procedurat e përcaktuara me kornizën ligjore në fuqi. Përzgjedhja e mësimdhënësve dhe udhëheqësve të institucioneve edukativo-arsimore, bëhet me përfshirjen e përfaqësuesve të këshillit drejtues, këshillit të prindërve, të komunitetit, të shoqërisë civile dhe ekspertë të jashtëm.

**Ngritja e cilësisë përmes procesit të regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë (X)** - Duke respektuar me përpikëri kriteret e përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kriteret e Drejtorisë së Arsimit dhe Udhëzimin administrativ nr. 22/2013, numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës, kemi ndikuar në përmirësimin e cilësisë së mësimit;

Trajnim për zhvillim profesional të personelit edukativo-arsimor, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe OJQ të ndryshme.

## Funksionalizimi i këshillave drejtues në të gjitha shkollat e komunës së Prishtinës;

Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues si: vizita informuese, speciale, kontrolluese, kthyese dhe të përgjithshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Prishtinës, zyrtarët e

Drejtorisë së Arsimit, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë vitit 2016 kanë realizuar 48 vizita informuese, 30 vizita speciale, 50 vizita kontrolluese, 15 vizita kthyese dhe 65 vizita të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar.

**Në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim dhe ngritjes së rezultateve të nxënësve,** nga tetori i vitit 2015, ka filluar implementimi i mësimit me qëndrim tërëditor, në tri institucionë edukativo-arsimore të nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në: SHFMU "Faik Konica", SHFMU "Model" dhe SHFMU "Afrim Gashi", ndërsa nga tetori i vitit 2016, ka filluar implementimi edhe në tri shkolla të tjera në: SHFMU "Emin Duraku", "Pjetër Bogdani" dhe "Ganimete Tërbeshi";

**Krijimi i hapësirave shkollore për t'i plotësuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore** - Drejtoria e Arsimit, këtë vit ka hapur edhe tri paralele të reja: në "Shkollën e Gjelbër", në shkollën "Ganimete Tërbeshi" dhe në shkollën filllore "Nëna Terezë"-Vranidoll; (dhe të gjitha edukatoret tashmë punojnë me nga dy grupe fëmijësh, pra është dyfishuar numri i fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor).

## Marrëveshje bashkëpunimi me institucione relevante të arsimit

Për angazhimin e studentëve në sferën e arsimit, është nënshkruar Memorandum mirëkuptimi me Fakultetin e Edukimit të Universitetit "Hasan Prishtina", me qëllim të zyrtarizimit të bashkëpunimit për zbatimin e praktikës profesionale të studentëve të dalluar



që përgatiten për mësimdhënës në shkolla, si dhe për krijimin e kushteve për përgatitjen e mësimdhënësve mentorë në shkollat përkatëse. Po ashtu, është nënshkruar edhe Memorandum bashkëpunimi me Galerinë Kombëtare të Kosovës;

**Marrëveshje bashkëpunimit** - Drejtoria e Arsimit dhe Qendra për Arsimin e Kosovës (KEC), kanë nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit që të zbatojnë së bashku projektin "Më mëso mua", gjatë periudhës shtator 2016 – qershori 2018. Ky projekt ka për qëllim aftësimin e mësimdhënësve për t'i shfrytëzuar burimet "online" në procesin mësimor për implementimin e Kurrikulës, si dhe për zhvillimin e kompetencave të nxënësve, për shfrytëzimin e këtyre burimeve në procesin e përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit të shkathtësive të tyre;

**Mbështetje në realizim të projekteve**  
Për punën dhe rezultatet e treguara në projektin "Kosovision", janë mbështetur dhe

financuar pesë (5) punimet më të mira të punuara nga nxënësit dhe mësimdhënësit e klasave të pesta; (në garën në nivel vendi, kemi fitues 10 mësimdhënës nga komuna e Prishtinës, rrëth 50%).

#### **Kampi veror "Roboticks"**

Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim e IPKO-në kanë organizuar kampin veror "Roboticks", në të cilin projekt kanë marrë pjesë nxënës të të gjitha shkollave të Kosovës, të cilët gjatë 4 ditëve janë inkurajuar dhe mbështetur të përdorin krijimtarinë dhe imagjinatën në lëmin e robotikës.

**Ceremonia e diplomimit të maturantëve** - Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe iniciativën e nxënësve maturantë, ka ndërmarrë veprime konkrete që 3500 maturantët e komunës së Prishtinës, graduimin ta shënojmë për herë të parë në mënyrë të organizuar dhe në një format me karakter festiv.

# Organizimi i garave dhe aktiviteteve të shumta në funksion të përmirësimit të rezultateve në arsim



Për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në arsim dhe për t'i nxjerrë në pah shkathtësitë dhe kompetencat e nxënësve të arritura në shkencat natyrore-shoqërore, dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, ka organizuar gara dhe aktivitete të ndryshme në këtë vit shkollor, si:

Garën "Olimpiada matematike";  
Garën "Olimpiada kombëtare e Kosovës në kimi";

Garën "Shkencëtar i ri", "Garat e Diturisë – Prishtina 2016";  
Garën "Eseja më e mirë";  
Garën "Poezia më e mirë" dhe garën "Piktura më e mirë" me nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar;  
Aktiviteti "Akademia për edukim për qytetarinë demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut".



Prishtina  
po bëhet